



Lake Shkoder-Skadar

INTEGRATED ECOSYSTEM MANAGEMENT PROJECT

Në brendësi

Takimi i 4rt i Komisionit të Liqenit të Shkodrës

Takimi i 4rt i Komisionit të Liqenit të Shkodrës	1
Përfaqësuesja e Përhershme e Bankës Botërore znj. Kseniya Lvovsky viziton rajonin e Shkodrës	1
Mrojekti MIELSH organizon udhëtim në terren	2
Modeli Hidrologjik Parashikues	2
Konferenca e donatorëve në Mal të Zi	3
Sondazh public mbi dukshmërinë e projektit	4

Takimi u zhvillua në 7 tetor 2011 në mjediset e Grand Hotel Europa në Shkodër në prani të medias lokale dhe kombëtare. Në këtë takim ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit të Liqenit të Shkodrës dhe kordinatorët e projektit në të dy shtetet. Z. Sajmir Hoxha-Drejtor i Biodiversitetit në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të Shqipërisë dhe Kryetar i Komisionit, në fjalën e tij shprehu mirënjohjen për homologët e Malit të Zi për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe menaxhimit e liqenit të Shkodrës. Ai gjithashtu theksoi rëndësinë e rezultateve të Projektit Menaxhimi i Integruar i Ekosistemit të Liqenit të Shkodrës (MIELSH), të cilat kanë krijuar një platformë të

vetme për menaxhimin e përbashkët të liqenit. Në fjalimin e tij ai falënderoi të gjithë këshilltarët dhe palët e interesuara të përfshirë në hartimin e dokumenteve të




përbashkëta dhe në zbatimin e aktiviteteve të projektit. Z. Sinisha Stankoviç, Zv. Ministër i Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit të Malit të Zi shprehu vlerësimet e tij për punën e bërë, për bashkëpunimin e krijuar ndërmjet ministrive për zbatimin e projektit. Ai

theksoi rëndësinë e vazhimit dhe rritjes së bashkëpunimit në të ardhmen. Ndër vendimet e marra në mbledhjen e komisionit ishin:

- Përgatitja dhe përcjellja e një letre të përbashkët në të gjitha institucionet kërkimore dhe vendore për të rikonfirmuar anëtarët aktual te grupeve te punes ose të emërojë anëtarë të rinj.

- Përgatitja e një marreveshje bilaterale ndërmjet qeverisë së Shqipërisë dhe Malit të Zi për arttijen e synimeve dhe objektiveve, për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të basenit ujëmbledhës të Liqenit të Shkodrës.

Përfaqësuesja e Përhershme e Bankës Botërore në Shqipëri znj. Kseniya Lvovsky viziton rajonin e Shkodrës



Përfaqësuesja e përhershme e Bankës Botërore në Shqipëri, Znj. Kseniya Lvovsky vizitoi rajonin e Shkodrës. Qëllimi i vizitës ishte të shihej zbatimi i disa projekteve të financuara nga Banka Botërore dhe të jepej një leksion në Universitetin Luigj Gurakuqi. Gjatë vizitës së saj ajo shoqërohej nga z. Lorenc Luka, Kryetari i Bashkisë së Shkodrës, si dhe nga ekipi i projektit që zbatoh

en në këtë zonë si ajo e projektit MIELSH. Znj. Lvovsky vizitoi disa nga investimet e financuara nga këta projekte përfshirë ripyllëzimin e Malit të Taraboshit me 45000 fidane pishe, rehabilitimin e përroit në Shirokë, rehabilitimi i rrugës kulturore të Gjuhadorit, dhe u takua me përfaqësues të Organizatës së Menaxhimit të Peshkatarëve, të cilët kanë përfituar pajisje



të reja të financuara nga Banka Botërore. Gjithashtu, znj. Lvovsky vizitoi një laborator të ri në fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Shkodrës të financuara nga Banka Botërore. Si pjesë e vizitave të saj në disa universitete, znj. Lvovsky dha një leksion për studentët e Fakultetit Ekonomik. Në leksionin e saj, Përfaqësuesja e përhershme për Shqipërinë, u përqendrua në zhvillimet e fundit ekonomike në Evropën Jug-Lindore dhe programin e Bankës Botërore. në vend.

**Zyra e Bankës Botërore
Tiranë**

Histori të Suksesshme

Fushata e ndërgjegjësimit për ruajtjen e Ujrave të Liqenit të Shkodrës

Projekti MIELSH organizon udhëtim në Liqenin e Shkodrës— në Konferencën e 6 Ndërkombëtare të Ujrave

Konferenca e 6-të Ndërkombëtare e Ujrave u organizua në 17-20 tetor 2011 në Dubrovnik dhe është një ngjarje tepër e rëndësishme. Kjo konferencë ishte një training aktiv dhe ndarje eksperiencash ku pjesëmarrësit jo vetëm u njohën me arritjet, por edhe vështruan të ardhmen. Konferenca u organizua nën logon "Raising the Bar: 20 vite rezultate të GEF në Ujra Ndërkufitar!". Ndër objektivat e konferencës ishte dhe promovimi i partneritetit publik privat në mbështetje të një menaxhimi më të mirë të ujrave dhe gjetjen e modaliteteve për zhvillim.

Në konferencë morën pjesë 300 pjesëmarrës përfshirë menaxherët e projekteve të GEF, përfaqësuesit e vendeve përfituese, organizatat jo-qeveritare, institucionet menaxhuese ndërkufitare agjencitë të UN dhe sektori privat. Më e reja e konferencës ishin workshopet e atypëratyshme, diskutimet në tavolinë, tregu i inovacionit, broshura me CD e përgatitura dhe



vizitat teknike në terren në disa nga projektet e GEF IW në rajonin e Dubrovnikut dhe në Liqenin e

Shkodrës ndermjet Malit të Zi dhe Shqipërisë. Projekti MIELSH ishte aktiv në konferencë përmes aktiviteteve të tilla si shpërndarja e materialeve promovuese për arritjet e tij dhe organizimi i një udhëtimi të paharrueshëm në Liqenin e Shkodrës. Kjo vizitë teknike në basenin e



Liqenit Skadar (Mali i Zi) - Shkodër (Shqipëri) i krijoi pjesëmarrësve mundësinë të vizitonin dhe të njiheshin me projektin më të avancuar të GEF IW në rajon. Projektet ndërkufitare ofrojnë shumë mësim sidomos për projekte të baseneve të ujrave të freskëta, për çështje të ndryshme përfshirë dhe:

- bashkëpunimi ndërinstitucional dhe krijimi i komisioneve të përbashëta ndërkufitare
- qasje të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik
- turizmi dhe peshkimi
- investime për të nxitur aktivitete për reduktimin e ndotjes
- trajtimi i ujrave të zeza në nivel fshati dhe rehabilitimi i bimësisë në zonat buferike.

Modeli Hidrologjik Parashikues

Në 27-29 shtator 2011 në Podgoricë të Malit të Zi në ambientet e Ministrisë së Turizmit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm u organizua workshopi për prezantimin e Modelit Hidrologjik. Pjesa e parë e këtij workshopi ishte teknike dhe ekspertëve ju prezantua Modeli dhe software-i përkatës. Në ditën e fundit ky model u prezantua për një numër më të madh aktorësh të shoqërisë civile. Studimi përmban gjetjet kryesore të Zhvillimit të një Modeli Parashikues Hidrologjik (PHM) për Zonën e Pellgut të Liqenit të Shkodrës (Shqipëri dhe Mali i Zi).

Modeli është i përbërë nga gjashtë elemente që modelojnë nënsistemet themelore të ciklit të ujërave lokale, nga atmosfera, tek sipërfaqja e lumit dhe tek hidrologjia nënujore e dinamika e liqenit. Elementi i parë është një model atmosferik i lidhur me një model të sipërfaqes tokësore dhe me një model të sipërfaqes hidrologjike për të simuluar reshje, dalje ujore sipërfaqësore të Moraçës dhe dalje të tjera lumore sipërfaqësore të liqenit dhe së fundi daljet ujore të infiltuara në tokë. Elementi i dytë është një model hidrodinamik i liqenit i cili është në bashkëveprim me hidrologjinë e lumit dhe që simulon nivelet e ujërave, rrymat dhe temperaturat. Elementi i tretë përbëhet nga dy modele të ujërave nëntokësore, për dy fushat aluviale të rajonit, dhe pikërisht ultësirës së Zeta-s dhe të Bunës. Elementi i katërt përmban dy modele hidrologjike të lumenjve, për Bunën dhe për rrjedhën e poshtme të Drinit në digën e Vaut të Dejës. Elementi i pestë është modeli i Lumit Buna dhe elementi i gjashtë lidhet me ujrat nëntokësor të fushës së Bunës. Të gjitha këto modele janë në bashkëveprim me frekuenca kohore ditore.

Pas përmbytjeve të vitit 2010-2011 në zonën e Shkodrës dhe të nën Shkodrës, ky model merr një rëndësi mjaft të madhe parashikuese për Shqipërinë dhe ndihmon në marrjen e masave parandaluese.

Konferenca e donatorëve në Mal të Zi



Në 13 dhjetor 2011 në zyrat e Ministrisë për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Turizmin në Podgoricë të Malit të Zi u mbajt takimi i dytë i donatorëve në lidhje me projektin MIELSH. Eventi synonte mbledhjen e të gjithë agjencive/aktorëve

aktiv në rajon dhe që kanë interes për projekte zhvillimi në Liqenin e Shkodrës për të shkëmbyer arritjet, planet dhe eksperiencat dhe për të ndërtuar mbi rezultatet e njëri tjetrit aktivitete të përbashkëta në të ardhmen.

Takimi synonte gjithashtu të shmangte mbivendosjet e aktiviteteve mes donatorëve të ndryshëm dhe do të promovonte lidhjet dhe sinergjitë ndërmjet projekteve të ndryshme në zonën e Liqenit të Shkodrës. Pas mirëseardhjes nga drejtorët e projektit: Z. Sinisa Stankovic dhe Z. Sajmir Hoxha, u ftuan të prezan-

tonin mbi aktivitetet e zbatuara dhe ato të planifikuara nga projektet e tyre aktuale të gjithë përfaqësuesit e organizatave/institucioneve ndërkombëtare si dhe koordinatorët e projektit .

Në takim ishin prezent dhe diskutuan përfaqësues të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara në Mal të Zi (UNDP), Programi Gjerman i Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Mal të Zi (GIZ), Qendra Rajonale e Mjedisit për Europën Jug-Lindore (REC Mal i Zi), Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Programi YEM i Bashkëpunësorëve të Jashtëm në UNDP Shqipëri.

Ekipi i BB për projektin MIELSH, Milieukontakt Shqipëri dhe Sekretariati i Komisionit të Shkodrës ishin gjithashtu prezent duke kontribuar në suksesin e këtij takimi.

Novak Cadjenovic
Koordinator i projektit MIELSH, Mali i Zi

Fushata për Ruajtjen e Cilësisë së Ujrave të Liqenit të Shkodrës

Gjatë periudhës shtator-dhjetor të vitit 2011, "Creative City" dhe "Shoqata Shqiptare për Zhvillim të Qëndrueshëm" në bashkëpunim me Bashkinë e Shkodrës dhe aktorë të tjerë lokal, organizuan fushatën e ndërgjegjësimit për ruajtjen e cilësisë së ujit të Liqenit të Shkodrës. Për tre fundjava rrjesht u organizuan aktivitete domostruese pas-trami të Liqenit nga nxënës të shkollave e aktorë të tjerë si bashkia, OMP, Agjencia Rajonale e Mjedisit. Qëllimi i saj ishte sensibilizimi i qytetarëve të cilët



duhet të jenë pjesë e kontributit për ruajtjen e cilësisë së ujit të Liqenit. Nxenes dhe mësues të shkollave 9-vjecare të qytetit në mënyrë vullnetare ju bashkuan aksioneve: "Unë e mbroj cilësinë e ujit të Liqenit të Shkodrës! Në mbrojtje të kësaj pasurie të madhe natyrore dhe ndalimin e hedhjes së

mbeturinave në liqen!"

Sic është shprehur koordinatori i projektit, Z. Armando Lohja: "Të rinjtë e shkollave nuk janë pjesë e ndërmarrjeve të pastrimit dhe nuk do të jenë të aftë të pastrojnë të gjithë bregun e liqenit por ato përcjellin mesazhin që të gjithë sëbashku mund ta arrijmë këtë gjë. Papastërtitë në sipërfaqen e tokës hiqen një ditë por papastërtitë gjatë bregut dhe në brendësi të liqenit janë më të vështira për t'u hequr, ndaj duhet të tregohemi të kujdesshëm për ruajtjen e cilësisë së ujit të liqenit".

Brenda një periudhe të shkurtër kohore ju ndryshua pamja bregut të liqenit dhe u grumbulluan me qindra thasë me mbeturina të depozituara si letër, plastikë dhe qelq. Aktivitetet e pastrimit u pasqyruan në TV lokale dhe u shoqëruan me mesazhe promocionale me anë të një spoti në TV, në rrjete sociale në internet si youtube, facebook dhe faqen e internetit të Creative City. Mesazhi ishte një thirrje apel qytetarëve të zonës përreth liqenit për të mbajtur pastër pasurinë e përbashkët, Liqenin e Shkodrës.

Po kështu një broshurë informative mbi tipet e ndotësve dhe mënyrat e reduktimit të tyre përfshirë mbrojtjen e zonave buferike u shpërnda në të gjithë qytetin e Shkodrës dhe në zonat ku janë të përqëndruar institucione të ndryshme publike, shkolla dhe bizneset.

Për tu informuar më shumë rreth kësaj fushate mund të klikoni në faqen e shoqatës "Creative City" dhe të projektit MIELSH tek seksioni i arkivës si dhe në adresën e Facebook "Creative City Shkoder AL".

Armando Lohja
Creative City



Sondazh publik mbi dukshmërinë e projektit

Në muajin dhjetor 2011 në kuadër të konsulencës për vlerësimin dhe monitorimin e projektit MIELSH, Milieukontakt zhvilloi një sondazh me publikun e Shkodrës mbi informimin e tyre për projektin.

U bënë 50 telefonata të perzgjedhura në mënyrë të rastësishme nga numratori telefonik i qytetit të Shkodrës. Sondazhi kishte për qëllim të maste nivelin e informimit të publikut përgjatë zbatimit të projektit dhe informacionit të ofruar nëpërmjet fushatave ndërgjegjëse.

Rreth 90% e të anketuarve ishin të njohur me zhvillimin e projektit të Liqenit dhe të marrëveshjes dypalëshe me qeverinë e Malit të Zi për menaxhimin e përbashkët të ujrave të Liqenit.

Ndër këta, 80% ishin informuar nëpërmjet medias lokale që informonte përmbi aktivitete nga zba-

timi i projektit të përbashkët. Ndërsa 40 % e të anketuarve vinin në dukje se përgjatë muajve nëntor-dhjetor televizionet lokale kishin shfaqur në mënyrë të vazhdueshme reklama dhe spote në kuadër të fushatës lokale ndërgjegjëse duke promovuar rëndësinë e ruajtjes së ujrave të këtij liqeni nga komuniteti.

Ndërkohë më të pakta ishin njohuritë përsa i përket strukturave që ishin ngritur, aktiviteteve dhe ndërhyrjeve të bëra në kuadër të projektit. Pjesa më e madhe e të anketuarve shpreheshin pozitivisht për ndalimin e gjuetisë gjatë sezonit të shumimit të krapit e vënë re nga sasia e paket e peshkut në treg. Organizata e Menaxhimit të Peshkut ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në parandalimin e gjuetisë së paligjshme por dhe licensimin e peshkatave për ushtimin e rregullt të aktivitetit.

Ajo që është interesante përgjatë sondazhit ishte interesi që tregonin qytetarët, për të mësuar mbi këtë projekt, strukturat e përfshira dhe arritjet e tij. Të gjithë pa përjashtim u shprehën që është gjë shumë e mirë që ka filluar të mendohet dhe strukturohet puna për menaxhimin e liqenit, që është burim i zhvillimit të turizmit, rritjes së të ardhurave ekonomike si dhe forcimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit ndërkufitar.

Po kështu nëpërmjet telefonatave u bë e mundur që qytetarëve tu jepej informacion mbi aktivitete, investime të zhvilluara në kuadër të projektit, si: Rehabilitimi i Rrugës së Gjuhadolit; Ripyllëzimi i Malit të Taraboshit; Krijimi i Administratës së Zonave të Mbrojtura; krijimi dhe funksionimi i SLC dhe Grupeve të punës, etj.

Informacione

Në kuadër të projektit të Liqenit të Shkodrës janë përgatitur dokumente të ndryshme nga konsulent vendas dhe ndërkombëtar. Dokumentet janë prezantuar dhe shpërndarë institucioneve respektive dhe mund të gjenden në web-site të projektit (<http://lss.iwlearn.org/>). Dokumente të tjerë janë në proces përgatitjeje dhe konsultimi. Faqe të tjera interneti ku janë pasqyruar aktivitete nga projekti:

- ◇ www.infoshkodra.com
- ◇ http://www.infoshkodra.com/images/stories/Broshura_Fushates_se_Ndergjegjesimit.pdf
- ◇ www.facebook.com ("Creative City Shkoder AL")
- ◇ <http://www.youtube.com/watch?v=XZJSMjeO9hI>
- ◇ <http://www.youtube.com/watch?v=nR8uk6cP20>

Financuar nga :



WORLD BANK



GLOBAL
ENVIRONMENT
FACILITY

Zbatuar nga:



Ministria e Mjedisit, Pyjeve
dhe Administrimit të Ujërave



Ministria e Zhvillimit të
Qendrueshëm dhe Turizmit

Ky publikim është përgatitur nga **Milieukontakt Albania** në kuadër të programit të konsulencës për monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të LSIEMP. Milieukontakt Albania është aktive që në vitin 2000. Qëllimi afatgjat i saj është "të zhvillojë një lëvizje të qëndrueshme dhe demokratike të organizatave mjedisore. Kjo do të thotë një lëvizje që ka një dukshmëri të lartë në shoqëri, të jetë e aftë të rrisë ndërgjegjësimin e publikut dhe të kenë aftësinë të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e politikbërjes dhe vendimmarrjes, në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar"

Adresa: Rr: Xhorxhi Martini, Pall. Teuta Konstruksion; Shk.3/8, P.O.Box:1700, Tirane/Albania
valbona.mazreku@milieukontakt.org

